


Simptomat e kancereve më të shpeshta te femra.

GJIRI

- Gungë e fortë në gji ose nën sqetull.
- Njollë e kuqe ose egzemë mbi lëkurën e gjirit.
- Ndryshimi i thithkës (madhësia, ngjyra) ose rrjedhje.
- Ndryshim i madhësisë midis dy gjinjve.

ZORRA E TRASHË

- Gjak që i jep jashtëqitjes ngjyrë të kuqe ose të zezë.
- Nevojë e rreme.
- Ndryshime të jashtëqitjes: të forta dhe/ose të lëngshme (alternime midis kapsllëkut dhe diarresë).
- Dhimbje të vazhdueshme barku.



MUSHKËRITË

- Kollë që vazhdon më shumë se prej 4 javësh.
- Kollë kronike që përkeqësohet.
- Infeksionet e mushkërive që nuk shërohen pavarësisht antibiotikëve.
- Gjak në pështymë.
- Vështirësi të pazakonshme të frymëmarrjes duke ngjitur shkallët
- Dhimbje gjoksi.

LËKURA

Njolla normale	Njolla që duhet të kontrollohen	
		Forma e rregullt?
		Skajet e përcaktuara mirë?
		E njëjta ngjyrë kudo?
		Ndryshimi i madhësisë? i formës? i ngjyrës? i trashësisë?

Nëse vëreni një nga këto simptoma, **kjo nuk do të thotë se ju keni kancer.** Caktoni takim me një mjek për një kontroll.

Çfarë mund të bëni çdo ditë për shëndetin tuaj:



ecni të paktën 30 minuta



hani 5 fruta dhe perime



kufizoni alkoolin në një gotë



mbroni veten nga dielli



shmangni pirjen e duhanit

Ekzaminimi për kontrollin e kancerit të gjirit



Unë jam 50 vjeç ose më shumë dhe vendos të bëj një kontroll.



Unë i telefonoj Fondacionit vaudoise për zbulimin e kancerit (0848 990 990) i cili më cakton një takim për të bërë një mamografi pranë shtëpisë sime.



Rezultatet më vijnë përmes postës, pas një jave.

- Nëse mamografia është normale, marr një ftesë për të ribërë kontrollin brenda 2 vjetësh.
- Nëse mamografia tregon një anomali, e thërras mjekun tim të familjes, i cili do të më dërgojë për të bërë një ekzaminim plotësues. Nëse nuk njoh një mjek, Fondacioni Vaudoise për zbulimin e kancerit merr kontakt me mua.



Ky kontroll më kushton rreth 20 franga. Sigurimi shëndetësor merr përsipër pjesën tjetër.

Ekzaminimi për kontrollin e kancerit të zorrës së trashë



Unë jam 50 vjeç ose më shumë dhe vendos të bëj një kontroll.



Plotësoj një pyetësor me një profesionist të shëndetit, i cili më jep një test për zbulimin e gjurmëve të gjakut në jashtëqitje.



E bëj vetë testin në shtëpi dhe e dërgoj në laborator duke përdorur zarfin e ofruar për këtë punë.



Rezultatet më vijnë përmes postës, pas një jave.

- Nëse testi është normal, marr një bon për të ribërë kontrollin brenda 2 vjetësh.
- Nëse testi tregon se ka gjak në jashtëqitjen time, unë e thërras mjekun tim të familjes, i cili do të më dërgojë për të bërë një ekzaminim plotësues (Kolonoskopia *). Nëse nuk njoh një mjek, Fondacioni vaudoise për zbulimin e kancerit merr kontakt me mua.



Ky kontroll më kushton rreth 5 franga. Sigurimi shëndetësor merr përsipër pjesën tjetër.

Kolonoskopia mund të zgjidhet si test i parë i kontrollit të kancerit të zorrës së trashë.

Nëse kam pyetje?
Thërras Fondacionin vaudoise për zbulimin e kancerit në nr. e telefonit:



0848 990 990



Albanais



Kanceri i zbuluar në fillim të sëmundjes rrit shanset e shërimit!